

KONTRATE DHURIMI E KUOTAVE TE SHOQERISE 'INVESTUM' Shpk

PALA DHURUESE:

Znj. ENEDA SHIMA, lindur në Durrës, me 22.09.1998 dhe banues në Durrës – Shqiperi ne adresen: Fshati Sukth; Nd. 230; Katundi I Ri me numer ID J85922104S, zoterues i 50% te kuotave te shoqerise 'INVESTUM' Shpk, NIPT M51512027D, me seli ne adrese Rruga: "Xhemal Tafai" ndertesa: 23, shkalla e pare app nr. 4, Njesia Administrative nr. 8 Tirane.

PALE PRANUESE E DHURIMIT

Z. ERALD HAROKU, ortaku tjetër i shoqerise, i lindur ne Tirane me 01.06.1987 dhe banues ne Rruga: "Xhemal Tafai" ndertesa: 23, shkalla e pare app nr. 4, Njesia Administrative nr. 8 Tirane, me nr ID I70601093K.

Neni 1

Baza Ligjore

Kjo kontrate hartohet ne baze dhe ne zbatim te neneve 761 e vijues te kodit civil.

Neni 2

Objekt i Kontrates

Ne kushtet kur dhuruesi heq dore nga administrimi i kuotave qe zoteron ne shoqerine 'INVESTUM' Shpk bie dakord per dhurimin e 50 % te kuotave te shoqerise tek pala pranuese e dhurimit, Z. Erald HAROKU.

Z. Erald HAROKU deklarone se pranon dhurimin e 50% te kuotave te shoqerise 'INVESTUM' Shpk prej Znj. Eneda SHIMA.

Neni 3

1. Detyrimet e pales dhuruese

1. Deklarone se eshte pronari 50% te kuotave te shoqerise 'INVESTUM' Shpk.
2. Garanton palen pranuese te dhurimit se keto kuota jane te lira nga cdo barre dhe detyrim karshi te treteve dhe per cdo pretendim qe mund te ngrene te tretet per cenimin e te drejtes se pronesise se pales pranuese te dhurimit, pala dhuruese eshte e gatshme dhe e detyruar te paraqitet menjehere me kerkesen e pales pranuese te dhurimit dhe te cdo personi tjetër te trete, qe pretendon mbi keto kuota, prane gjithe organeve gjyqesore dhe administrative per te mbrojtur te drejten e tij, si pronar i ligjshem i ketyre kuotave pas nenshkrimit te kesaj kontrate.

Neni 4

Detyrimet e pales pranuese te dhurimit:

1. Pala pranuese e dhurimit ka marre ne dorezim kuotat, duke mos patur asnje verrejte sipas dokumentit ligjor.
2. Pala pranuese e dhurimit merr persiper te gjitha detyrimet nga pronesia e kuotave prej nenshkimit te kesaj kontrate.

Neni 5

Detyrimet dypaleshe:

3. Palet kontraktuese deklarojne se te gjitha detyrimet e pershkruara me lart dhe te gjitha ato qe burojne nga kjo kontrate dhurimi jane realizuar prej tyre dhe ata nuk kane asnje detyrim te ndersjellte midis tyre dhe nuk do te kete asnje detyrim ne te ardhmen.
4. Palet kontraktuese deklarojne se kuotat jane marre ne dorezim nga pala pranuese e dhurimit ne gjendjen qe jane ne momentin e nenshkimit te kontrates dhe palet nuk kane asnje pretendim ne lidhje me kete veprim.

Neni 6

PASOJAT TRANZATORE TE KALIMIT TE AKSIONEVE

1. Pala dhuruese si dhe pala pranuese jane solidarish pergjegjes ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotave objekt i kesaj kontrate deri ne momentin e regjistrimit ne QKB te ndryshimit te pronesise.
2. Pergjegjesia solidare e pales pranuese te dhurimit ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotave objekt i kesaj kontrate fillon nga casti i kalimit te kuotave nepermjet nenshkrimit te kuotave me regjistrimin e ketij kalimi ne perputhje me dispozitat e ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Regjistrimin e Biznesit" dhe ligjit nr.131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".

Neni 7

EFEKTET E KONTRATES

1. Kalimi i pronesise se kuotave nga pala dhuruese tek pala pranuese ne perputhje me percaktimet e kesaj kontrate perfundon me regjistrimin e kesaj kontrate prane QKR dhe ne perputhje me percaktimet e ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Regjistrimin e Biznesit" dhe ligjit nr.131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".

2. Kalimi i kuotave sipas kesaj kontrate regjistrohet ne perputhje me dispozitat e ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Regjistrimin e Biznesit" dhe ligjit nr.131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".
3. Regjistrimi i percaktuar ne piken 2 te ketij neni ka efekt deklarativ.

Neni 8

Dispozita te fundit

1. Me firmosjen e kesaj kontrate nga palet kontraktuese,
Pala dhuruese Znj. Eneda SHIMA, zhvishet nga pronesia e 50% e kuotave qe zoteronte ne shoqerine 'INVESTUM' Shpk
2. Pala pranuese Z. Erald HAROKU behet zoterues ne 100% te kuotave te shoqerise
3. Palet deklarojne se do te kryejne veprimet per regjistrimin e kesaj kontrate ne QKB sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi.
4. Kontrata ka 3(tre) faqe dhe u hartua ne 3 kopje.


PALA DHURUESE

ENEDA SHIMA



PALA PRANUESE

Erald Haroka



Tirane me, 21/05/2025